


**Natasa Angjeleska**

# **DJALOSHI I RRALLË**

## **DHE TULLUMBACJA FOLËSE**



ilustrime  
**Aleksandar Sotirovski**





Natasa Angjeleska

# **DJALOSHI I RRALLË DHE TULLUMBACJA FOLËSE**

Ilustrime dhe dizajn:  
Aleksandar Sotirovski

Përkthimi në gjuhën shqipe:  
Vjosa Taipi

Punimi i librëthit me vizatime është mbështetur nga









Festa e ditëlindjes filloi para gjysmë ore.

Djaloshi ishte shumë i emocionuar dhe që në shtëpi filloi me planet me kë do të luajë me top, me kë bilardo apo bouling, por edhe si do të kërcejë kur do të lëshojnë muzikë, ndërkaq shpresonte që në sallën e lojërave ku po shkonte, të ketë një disko top në tavan, sepse është shumë interesante kur bashkohen ngjyra të ndryshme dhe lëvizin rreth teje.

Por, sapo mbërriti në sallën e lojërave, filloi të luante lojërat që kishte planifikuar, përnjëherë ndjeu se nuk mund ta lëvizte dorën. Iu bë e rëndë dhe nuk mundi t'i lëvizte gishtat. I trishtuar, u ul në cep të sallës së lojërave dhe u ndje shumë i lodhur, edhe pse ditëlindja e tij sapo kishte filluar. Nuk bëri asgjë të veçantë sot, edhe pse krahët dhe këmbët e tij nuk donin më të luanin me fëmijët e tjerë me tullumbacet e ditëlindjes. Ndërkaq, fëmijët të tjerë vazhduan lojën pa brenga duke mos vënë re se ai nuk ishte aty.







I ulur vetëm, fliste me veten: Më nuk do të bëj më kurrfarë planesh përpara se të arrij diku. Planet e mia nuk realizohen kurrë.

Por befas, ndjeu një prekje të butë në krah, që po i bëhej më i rëndë dhe më i trashë, po ënjtej. E preku tullumbacja Blu.

E pa në sytë e tij të trishtuar dhe e pyeti: "Pse nuk po luan më? Mos u zemërove që po më zhduken forca dhe madhësia? Fillova të shfryhem, por me të vërtetë më lodhët shpejtë!"







Djaloshi u tremb për një çast nga prekja e papritur, por më shumë u befasua nga e folura e qetë që dëgjoji. U kthye majtas, djathtas dhe shikoi mos ishte fshehur ndonjë nga fëmijët që po përpiquej ta tallte duke e bërë të mendojë se po fliste tullumbacja. Nuk vërejti askënd përreth, dhe e pa tullumbacen i çuditur.

Si mund të flasë një tullumbace? -pyeti veten. Madje edhe të ankohet?!?  
Megjithatë mos bëhet fjalë për ndonjë shaka dhe aspak nuk e ka punën për shaka, nuk ndihet mirë.







Por sigurisht se kishte nevojë të flasë me dikë, sepse të gjithë fëmijët e tjerë ishin zhytur në lojë me tullumbacet e tjera.


Prandaj i tha: Nuk jam i zemëruar me ty. Jam i zemëruar me veten time... Vetëm ta dish se çfarë plane kisha për sot. Shpika hapat tim dhe koreografinë time për vallëzim, nëse do të kishte mikrofon do doja edhe të këndoja, si në një festë karaoke, të kujtohet! Por ja, asgjë prej kësaj... Dhe e di që do të kisha fituar në bouling, mirë më filloi. Sigurisht do të fitoja pikë të mira dhe do të merrja ato hedhjet bonus që i llogarit kompjuteri. Eh, sikur të durohesha të paktën deri për tortën, nëse dora ime nuk do të ënjtej të paktën deri në fund të ditëlindjes sime, që të mund të luaja edhe pak më shumë dhe pastaj të shkoja në spital...





Tullumbacja u befasua që djaloshi po fliste aq me pasion për planet e tij dhe tani ai është aq i plogësht, kështu që e pyeti i brengosur, edhe pse edhe ai gradualisht po e humbte forcën dhe po bëhej më i vogël, po shfryhej: Po pse do të shkosh në spital? E ke lënduar dorën? Mos e kishe tepër të rëndë topin e boulingut? Apo ndoshta tepër fuqishëm e hidhje para se ta lëshoje në pistën e boulingut? Apo ndoshta nxitoje dhe nuk kishe kujdes kur e mbaje topin dhe pastaj u lëndove?






Djaloshi e vështroi me shikim edhe më të trishtueshëm dhe qetë i shpjegoi:  
Por tani, kjo nuk është arsyeja, nuk është hera ime e parë që bëj bouling.

E di se si duhet mbajtur topi dhe si të hidhet drejtë kunjave! Diçka tjetër është në pyetje. Nëse të intereson ja pra do të ta shpjegoj. Unë kam një sëmundje shumë të rrallë dhe shpesh ënjtem... Pa e ditur pse, thjesht mund të ënjtem. Kudo.

Ndonjëherë në dorë, nganjëherë në këmbë, por mundet edhe në fytyrë, kështu që më mbyllen edhe sytë dhe nuk mund as të shoh. Ndonjëherë kam ënjtje në shpinë, por nëna më tepër shqetësohet kur më dhemb fyti, se mos më ënjtet fyti. Atëherë e kam vështirë të flas dhe nuk mund të gëlltis... Mund të më merret edhe fryma... Kjo është arsyeja pse duhet të shkoj në spital, se atje më japin ilaçin.








Tullumbacja aq u trishtua, sa që krejtësisht qetë iu hodh në dorën e tij të ënjtur dhe i tha: Të lutem më merr në spital, dua të jem pranë teje. Unë kam frikë nga gjilpërat, por ti je i guximshëm dhe dua ta ndiej guximin tënd, qoftë edhe nëse kurrë nuk do të mund të rritem dhe të luash me mua.

Të lutem më merr edhe mua. Të premtoj se do të jem i mençur, do të rij i fshehur në xhepin tënd dhe askush nuk do ta dijë se jam me ty. Të lutem më merr me vete, nuk më duket më interesant, pasi dëgjova se si ndjehesh, ty të nevojitem shumë më tepër.

Tullumbacet të tjera do të luajnë me fëmijët të tjerë, me siguri nuk do ma zënë për të madhe që nuk do të jem këtu.



The illustration shows a hospital room. In the foreground, there is a blue bed frame. In the background, a window is visible with light-colored curtains. A blue cabinet or desk is positioned in front of the window, with a white electrical outlet and a cord plugged into it. The overall scene is brightly lit, suggesting a clean and professional environment.


Djaloshi e futi tullumbacen në xhep, ndërsa nëna e tij e shqetësuar, e ndihmoi që të vishte xhaketën dhe të shkonin në spital. Ajo ja përkëdhelte kokën dhe i buzëqeshte ndërsa shkonin rrugës për në spital. Gjatë rrugës, u dëgjua me infermieret që ta përgatisin solucionin e terapisë dhe kështu çdo gjë të jetë gati për engjëllin e saj të vogël që ta merrte sa më shpejt terapinë që i shpëtonte jetën. Kur arritën në spital, vërtet, infermierja Mimi i priti e buzëqeshur, madje ajo i kishte përgatitur një dhomë të veçantë ku ai do të shtrihej ndërsa do të vazhdonte terapia, por edhe do të pushonte pak.

Në televizor kishin lëshuar kanalin për fëmijë me filma të animuar.

Erdhi edhe doktoresha që ta përshëndesë dhe ta qortojë: A nuk u morëm vesh se nuk do të shihemi shumë shpesh? Duhet të rritesh pakës, që kur të të matim, të mund të shkruajmë numra të rinj në kartën e spitalit.

Djaloshit nuk i flitej, por ai buzëqeshi në mënyrë të kulturuar dhe e përshëndeti.





Dy orë më vonë, kur djaloshi doli nga spitali dhe kur ecën drejt makinës me prindërit, ai e futi dorën e dobësuar në xhep dhe e gjeti tullumbacen.

I lumtur që ndihej më mirë, e fryu tullumbacen të madhe blu dhe filloi të luante me dorën e tij, të cilën përsëri e përdorte në mënyrë normale. Një buzëqeshje u përhap në fytyrën e tij, por edhe në fytyrën e nënës së tij.

Madje asaj iu mbushën sytë me lot nga gëzimi kur pa të birin se edhe përkundër ardhjes së paplanifikuar në spital, djaloshi i saj ishte në gjendje të luante dhe të argëtohej përsëri.





U kthyen në shtëpi ku e priti një surprizë e këndshme. Shokët me të cilët ishte në ditëlindje kishin sjellë tullumbace shumëngjyrëshe dhe donin ta vazhdonin lojën e festës së ditëlindjes. A është e mundur kjo?!!

Djaloshi dhe tullumbacja ishin shumë të lumtur! Kuptohet, menjëherë e pranuan ftesën nga shokët dhe vazhduan të argëtohen, pothuajse sikur asgjë të mos e kishte ndalur lojën e tyre gjatë atyre dy orëve. Për një çast ata u ndanë nga të tjerët, u panë me tullumbacen dhe premtuan se sa herë që djaloshi ënjtet dhe do t'i duhet terapi, tullumbacja gjithmonë do të shkojë me të, që pastaj të vazhdojnë shoqërimin dhe lojën e përbashkët, si shokë të vërtetë, besnikë.

